



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВА - REPUBLIC OF KOSOVA QEVERIA E KOSOVËS - ВЛАДА КОСОВА - GOVERNMENT OF KOSOVA ZYRA E KRYEMINISTRIAT - УРЕД ПРАВИТЕЛА - OFFICE OF THE PRIME MINISTER SEKTORI I ARKIVËS - СЕКТОР АРХИВЕ - ARCHIVE SECTOR	
Nësimi Org. Org. Unit	02.10
Nr. Prot. Prot. No.	574
Nr. i faqeve Br. stranica No. pages	- 2 -
Data: Datum: Date:	04/06/2025
Prishtinë/a	

Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Datë: 04.06.2025

Mbledhja e 261-të e Qeverisë së Republikës së Kosovës mbahet më 05.06.2025, në orën 10:00, ndërtesa e Qeverisë, salla P-31.

RENDI I DITËS

1. Shqyrtimi i Propozim-vendimit për aprovimin e Ekstraktit të Procesverbalit dhe të Transkriptit të mbledhjes së 260-të të Qeverisë së Republikës së Kosovës (ZKM)
2. Shqyrtimi i Projekt-rregullores për Trajnimin dhe Testimin e Detyrueshëm, si dhe Certifikimin e Inspektorëve të Republikës së Kosovës (ZKM)
3. Shqyrtimi i Propozim-vendimit për emërimin e katër (4) anëtarëve të Bordit Mbikëqyrës të Ndërmarrjes Publike Qendrore "Trepça Sh. A." (ZKM)
4. Shqyrtimi i Propozim-vendimit Preliminar për shpronësim për interes publik të pronave të paluajtshme të pronarëve dhe zotëruesve të interesit, të cilat preken nga realizimi i projektit: "Ndërtimi i Qarkores së Jashtme të Qytetit të Gjilanit dhe Kycja e Rrugës Nacionale N25.2 dhe N25.3 deri te Autoudha R7.1" (MMPHI)
5. Shqyrtimi i Propozim-vendimit Preliminar për shpronësim për interes publik të pronave të paluajtshme ish-shoqërore "Mekanizmi", që menaxhohen dhe administrohen nga AKP-ja, shpronësimi i të cilave është i nevojshëm për realizimin e projektit: "Ndërtimi i ndërtesave të banimit të përballueshëm dhe social për Komunën e Podujevës" (MMPHI)
6. Shqyrtimi i Propozim-vendimit për ndryshimin dhe plotësimin e Vendimit të Qeverisë Nr. 12/253, të datës 21 mars 2025 (MMPHI)
7. Shqyrtimi i Propozim-vendimit për hartimin e Planit Hapësinor për Kompleksin Memorial "Adem Jashari" në Prekaz (MMPHI)
8. Shqyrtimi i Propozim-vendimit për emërimin e Komisionit Ad-hoc për Vlerësimin Profesional për Pranim në Pozitën e lartë të Kategorisë Drejtuese: Drejtor Ekzekutiv në Agjencinë e Regjistrimit të Bizneseve të Kosovës (MINT)

9. Shqyrtimi i Propozim-vendimit për rialokimin e mjeteve në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal nga kategoria e "Shpenzimeve kapitale", nga projekti kapital "Programi komunal për zhvillim të infrastrukturës socio-ekonomike dhe bashkëpunim ndërkomunal", në 1 (një) projekt kapital, në përputhje me 1 (një) marrëveshje të mirëkuptimit për projektin kapital, të nënshkruar nga Ministri i MAPL-së dhe Kryetari e Komunës së Pejës (MAPL)

10. Të ndryshme